



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:194691
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05470556

Ac.nr.1968/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H. K., adresa: fsh, Kryshevc, Komuna Obiliq, i përfaqësuar nga R. K., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me seli në Prishtinë, objekti i kontestit kompensim i dëmit, vlera e objektit të kontestit 1055.83€, duke vendosur sipas ankesës të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.959/10, i datës 11.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.959/10, datë 11.12.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.959/10, i datës 11.12.2020, ka vendosur si në vijim: aprovohet në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit H. K., nga fshati Kryshevc, Komuna e Obiliqit dhe detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të fitimit të humbur për shkak të pamundësimin të shfrytëzimit të tokës bujqësore në pjesët e ngastrave kadastrale 00010-1 dhe 00011-1 ZK Fushë Kosovë, të dëmtuara për shkak të hirit, t'ia paguaj shumën prej 1.055,83 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri ne pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i të paditurit në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim gjykatës së shkallës së dytë të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të refuzoj kërkesëpadinë, apo të prishë aktgjykimin e atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se pala e paditur ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse përmes të autorizuarit të saj me datë 05.05.2010 ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, lidhur me dëmin e pretenduar që i'u ishte shkaktuar në pjesë të ngastrave kadastrale 00010-1 dhe 00011-1 Zona Kadastrale Fushë Kosovë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, nxjerrjes së ekspertizave nga lëmia e gjeodezisë dhe bujqësisë si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjyimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësimin se në kuptim të vërtetimit të gjendjes faktike, fillimisht duke nxjerrë ekspertizën e gjeodezisë, që kishte të bënte me vërtetimin e sipërfaqeve që ishte e mbuluar me mbetje të hirit, po ashtu ka nxjerrë ekspertizën nga lëmia e bujqësisë, për të vërtetuar bazën e kërkesëpadisë. Në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë ka ardhë në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar. Po ashtu është dhënë arsyetimin se bazuar në ekspertizën gjeodezike në posedim dhe shfrytëzim faktik të ngastrave kadastrale nr. 10-1, me sipërfaqe prej 0.97.24 ha, në vendin e quajtur Gniva dhe ng. kadastrale 11-1 me sipërfaqe prej 0.31.87 ha, të dyja në ZK Fushë Kosovë, të cilat si ngastra janë në tërësi unike dhe nuk kanë kufi me njëra tjetrën. Sipas ekspertizës deponia e hirit fillonte në pjesën lindore të ngastrave lëndore duke e tanguar edhe një pjesë nga këto ngastra në sipërfaqe prej $S=18.77$ m², kjo vazhdonte në veri në mënyrë valore, në shtim të nivelit në pjesën veriore. KEK kishte hapur një vijë në formë kanali, për ta mbrojtur pronën private nga vërshimet, por vet mënyra e hapjes së kanalit, len përshtypjen e një largimi të përkohshëm të ujit atmosferik, por nga rrëshqitja e deponisë së hirit, kohë pas kohe mbyllet kanali i tanishëm, me tendencë të rrëshqitjes së vet kanalit, pasi nuk ka vendosur ndonjë shirit mbrojtës, që do ta pamundësojë rrëshqitjen e hirit. Kurse nga ekspertiza e bujqësisë, është vërtetuar se fitimi i humbur për periudhën kontestuese 2008-2010, për sipërfaqen prej 1877m², për të cilën eksperti i gjeodezisë Adem Ahmetaj, ka konkluduar se është e mbuluar me hi. Sipas ekspertizës plotësuese të datës 20.10.2020, eksperti ka bërë llogaritjen e fitimit të humbur për mos shfrytëzimin e tokës, si pasojë e mbulimit me hi të sipërfaqes së tokës, për vitet 2008, 2009 dhe 2010. Këto llogaritje, eksperti i bujqësisë, i ka bërë për sipërfaqen prej 1877m², duke vërtetuar se humbjet janë 1.055,83€.

Më tej ka aryetuar se në bazë të dispozitave të lartcekura, Gjykata erdhi në përfundim se paditësi, për shkak të deponisë së hirit të TC Kosova A të paditurës KEK, e cila e mbulon edhe sipërfaqen prej 1877 m² të ngastrave 10-1 dhe 11-1 ZK Fushë Kosovë, në pronësi të paditësit, i ka shkaktuar dëm në pamundësimin e shfrytëzimit të tokës bujqësore. Ky dëm, sipas Gjykatës, e duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit të bujqësisë, manifestohet për shkak të mbulimit me hi të pjesës së këtyre ngastrave të cilat shkaktojnë uljen e rendimentit nga ndikimi negativ i hirit (më konkretisht si në ekspertizën e ekspertit Skender Kaçiu).

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Nuk kishte pretendim ankimor specifik për sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, prandaj gjykata kufizohet në vetëm ato që kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndron pretendimet ankimor për konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjykata përmes ekspertizës së gjeodezisë, ka arritur deri tek identifikimi i pjesë të ngastrave kontestuese që pretendohet se janë mbuluar me hi nga e paditura, është bërë skicimin e tyre. Po ashtu është vërtetuar se pronar i atyre ngastrave kadastrale është paditësi. Kurse për të llogaritur bazën e kërkesëpadisë, është nxjerrë ekspertiza e bujqësisë, duke vërtetuar se për periudhën kontestuese 2008, 2009 dhe 2010, sipas sipërfaqes së tokës prej 1877m² sipas matjeve gjeodezike të ekspertit të gjeodezisë të mbuluar me hi. Për këtë sipërfaqe të papërdorshme të tokës eksperti ka konstatuar se fitimi i humbur për vitin 2008 neto është në shumë prej 320,50 euro, për vitin 2009 në shumë prej 128,95 euro si dhe fitimi neto për vitin 2010 në shumë prej 320,50 euro. Sipas kalkulimeve të ekspertit përmbledhja e kompensimit për tri vite është 769,95 Euro, ndërsa humbjet për sipërfaqen janë 285,87 Euro. Shuma e përgjithshme e humbjeve që e paditura duhet kompensuar paditësit, sipas ekspertit është 1.055,83 Euro. Nga analizimi i thënieve në ankesë, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keqinterpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një provë e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë kualifikimin në harmoni me të drejtën materiale. Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të njëjtën. Kjo gjykatë gjen se në kuptim të nenit 185 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare nr.29/78 (LMD) *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla”*. Rrjedhimisht gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, ngase paditura duhet të mbahet përgjegjëse për shkaktimin e dëmit në këtë rast kontestues. Kjo ngase e paditura me veprimet e saj, e ka dëmtuar pronën e paditësit, duke i hedhur mbetje hiri në të, në këtë

mënyrë duke e pamundësuar paditësin të punoj të njëjtën. Gjykata Apelit duke u bazuar në dispozitat e LMD-së, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallen e dëmit, pamundësinë e punimit dhe kultivimit në tokën bujqësore, si dhe vlerësimin në ekspertizave, aprovoi qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, se paditësit i takon kompensimi në lartësinë e aprovuar, duke vlerësuar të njëjtën si adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave do t'iu mundësoj atyre t'i kompensojnë të mirat materiale nga të cilat është privuar, respektivisht ato të mira të cilat do t'i posedonin po që se do të mund të kultivonin kulturat bujqësore në parcelën e tij

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.1968/2021, datë 11.03.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli